



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**GJYKATA E POSAÇME E APELIT PËR KORRUPSIONIN DHE KRIMIN E  
ORGANIZUAR  
KANCELARI**

Nr. 109 Prot.

Tiranë, më 22.01.2024

**Lënda:** *Njoftim mbi rezultatet e verifikimit paraprak për pranimin në shërbimin civil gjyqësor në kategorinë ekzekutive Specialist IT dhe Statistikë, në Sektorin e IT, Statistikë dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median, kategoria IV-1.*

**KËSHILLIT TË LARTË GJYQËSOR**

*Godina "Poli i Drejtësisë", Rruga "Ana Komnena", Tiranë.*

Në zbatim të nenit 6 të ligjit nr. 95/2016 "Për organizimin dhe funksionimin e institucioneve për të luftuar korrupsionin dhe krimin e organizuar", nenit 28, pika 1, të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020, të Këshillit të Lartë Gjyqësor "Për lëvizjen paralele, ngritjen në detyrë dhe pranimin në shërbimin civil gjyqësor", Kancelari në përfundim të verifikimit paraprak të kandidatëve, për përmbushjen e kriterëve të pranimit sipas nenit 25, pika 1 gërma a dhe b të këtij vendimi si dhe kërkesave të përcaktuara në shpalljen për konkurim, ju njoftojmë se për pozicionin:

- **Specialist IT dhe Statistikë, në Sektorin e IT, Statistikë dhe Marrëdhënieve me Publikun dhe Median,**

Është paraqitur 1 (një) kandidat, i cili plotëson kushtet e përgjithshme:

**Elvis Laskaj**

Në lidhje me kriteret e veçanta (kushtet e sigurisë që duhet të plotësojnë kandidatët përpara se të caktohen apo punësohen në këtë pozicion, sipas nenit 6 të ligjit nr. 95/2016), për të vazhduar më tej me procedurën e pranimit sipas nenit 27 të Vendimit nr. 622, datë 10.12.2020 të KLGJ, pritet Raporti nga Komisioni i Posaçëm i Verifikimit të Pasurisë dhe Figurës.

*Duke Ju falënderuar për bashkëpunimin!*



**KANCELARI**

**Elka Dajçi**